



# BESIMI NË SHOQËRINË CIVILE

2008

**Botues**

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS)

**Për botuesin**

Sasho Klekovski  
Drejtor i parë ekzekutiv

**Autorë**

Sasho Klekovski  
Aleksandar Krzhhalovski  
Sunçica Sazdovska  
Gonce Jakovleska

**Koordinator i projektit**

Daniela Stojanova

**Përktheu**

Ermira Kuçllar

Shkup, dhjetor 2008

**Tirazhi:**

300

CIP – Каталогизacija во публикација  
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.653:342.5(497.7)“2007”  
342.5:316.6533(497.7)“2007”  
316.653:061.2(497.7)“2007”  
061.2:316.653(497.7)“2007”

BESIMI në shoqërinë civile / [autorë Sasho Klekovski... [и др.]; përktheu Ermira Kuçllar]. – Shkup : Qendra maqedonase bashkëpunim ndërkombëtar, 2008. – 35 стр. : табели ; 23 см

ISBN 978-9989-102-75-2

1. Klekovski, Sašo [автор]

а) Јавно мислење – Државни институции – Македонија – 2007 б) Државни институции – Јавно мислење – Македонија – 2007 в) Јавно мислење – Невладини организации – Македонија – 2007 г) Невладини организации – Јавно мислење – Македонија – 2007

COBISS.MK-ID 75393034

Copyright © 2008 Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS), Shkup.  
Të gjitha të drejtat i ka botuesi.

Mendimet e shprehura këtu u takojnë autorëve dhe nuk i reflekton qëndrimet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

## PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>4</b>
<b>PARATHËNIE .....</b>	<b>5</b>
<b>RESYMEJA PËRFUNDIMTARE .....</b>	<b>6</b>
<b>INDEKSE.....</b>	<b>7</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>9</b>
Nocione dhe definicione.....	9
Metodologjia dhe qasja.....	9
<b>I. BESIMI DHE BESIMI NË INSTITUCIONET .....</b>	<b>11</b>
Hyrje .....	11
Besimi në të ngjashmit dhe besimi i përgjithshëm .....	11
Besimi në institucionet .....	11
Besimi në sektorin shtetëror .....	12
Besimi në sektorin afarist .....	13
Besimi në sektorin civil .....	14
Besimi në profesionet .....	14
Përfundime.....	16
<b>II. TOLERANCA .....</b>	<b>17</b>
Përundim.....	18
<b>III. BESIMI NË KISHAT DHE BASHKËSITË FETARE .....</b>	<b>19</b>
Përfundime.....	20
<b>IV. QËNDRIME PËR ORGANIZATAT QYTETARE .....</b>	<b>21</b>
Organizatat qytetare dhe partitë politike .....	21
Përfundime.....	23
<b>V. NJOHJA DHE MENDIME PËR ORGANIZATAT QYTETARE NË MAQEDONI.....</b>	<b>24</b>
Hyrje .....	24
Njohja e organizatave qytetare .....	24
Qëndrime (pozitive/negative) për organizatat qytetare .....	28
Njohja e personaliteteve nga sektori civil.....	29
Përfundime.....	30
<b>SHTOJCË: PYETSORI .....</b>	<b>31</b>

## LISTA E SHKURTESAVE

- ADI: Asociacioni për Iniciativa Demokratike  
BDI: Bashkimi Demokratik për Integrim  
BIM: Bashkësia Islame e Maqedonisë  
BNJVL: Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale  
BOIM: Bashkësia e Organizatave të Invalidëve të Maqedonisë  
BSE: Shoqata për Barazi, Solidaritet dhe Emancipim  
FISHHM: Fondacioni Instituti Shoqëria e Hapur - Maqedoni  
FZHMN: Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje  
IHSPJ: Instituti për Hulumtime Sociologjike dhe Politiko-Juridike  
KHDNJ: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë  
KKRM: Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë  
KOM: Kisha Ortodokse Maqedonase  
LEM: Lëvizja e Ekologëve të Maqedonisë  
LOGM: Këshilli Kombëtar i Grave të Republikës së Maqedonisë  
LSDM: Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë  
LSHPM: Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë  
LSUQM: Lidhja e Studentëve të Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi"  
MCMS: Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar  
OKM: Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë  
OQ: Organizata Qytetare  
PDSH: Partia Demokratike Shqiptare  
QIQ: Qendra për Iniciativa Qytetare  
QZHI: Qendra për Zhvillim Institucional  
SHGM: Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë  
VMRO-DPMNE: Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas  
VMRO-PP: Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Popullore

## PARATHËNIE

MCMS për herë të tretë e hulumtoi besimin e përgjithshëm, besimin në institucionet, tolerancën dhe besimin në shoqërinë civile.

Për herë të parë e hulumtoi në vitin 2006, si pjesë e orientimit të vet drejt “planifikimit (dhe përfaqësimit) të bazuar në fakte”, MCMS e botoi raportin “Besimi dhe bamirësia në Maqedoni”. Në vitin 2007 raporti u nda në dy pjesë të veçanta për besimin dhe përgjegjësinë qytetare (duke përfshirë edhe bamirësinë).

Këtë vit gjithashtu u përgatit raport i veçantë për “Besimin në shoqërinë civile”. Në atë janë prezantuar rezultatet dhe përfundimet nga hulumtimi i besimit në Republikën e Maqedonisë, të realizuar mes anketës gojore në ekzemplar kombëtar reprezentues. Përsëri janë dhënë më shumë indekse për përcjelljen e besimit, me të cilat do të lehtësohen analizat e trendeve. Risi është inkuadrimi i hulumtimit të besimit në kishat dhe bashkësitë fetare. Është bërë ndryshim edhe në publikimin e raportit. Këtë vit MCMS vendosi që raportin ta publikojë në disa pjesë, ndërsa raportin përfundimtar të hulumtimit ta botojë në version elektronik në gjuhën maqedonase dhe angleze.

Me përsëritjen periodike të raportit dhe lehtësimin e përcjelljes së trendeve të besimit në Republikën e Maqedonisë mendojmë se do ta përmirësojmë shfrytëzimin e këtij raporti.

Autorët

## RESYMEJA PËRFUNDIMTARE

Raporti “Besimi në shoqërinë civile” vjen si rezultat i nevojës që të shihet se sa është besimi i qytetarëve në organizatat qytetare. Raporti shkon edhe më larg. Ai jep pasqyrë të gjerë të besimit, duke përfshirë përveç sektorit civil edhe dy të tjerë, atë shtetëror dhe privat. Gjatë kësaj, mundëson shqyrtim të qëndrimeve të qytetarëve për tre sektorët. Numri i madh i variablave socio-demografike mundëson që të shihet se si qëndrimet dhe deklaratat bashkëveprojnë me treguesit social, përkatësinë gjinore dhe etnike ose rajonin ku jetojnë. Anketimi i ekzemplarit reprezentues është zgjedhur si metodologji e mirë për hulumtimin e besimit.

Hulumtimi tregoi se në Maqedoni besimi i përgjithshëm dhe besimi në institucionet është relativisht i ulët. Qytetarët kanë besim të madh në të ngjashmit – besimi në familje (97,8%) dhe besim të përgjithshëm më të ulët (23,1%) dhe besim në institucionet.

Indeksi i besimit në institucionet është 43,8 me rritje të besimit në shtet (48,1%) dhe zvogëlimi i besimit në sektorin afarist (47%), sektorin civil (41,7%) dhe në bashkësinë ndërkombëtare (42,8%). Vërehet rritje e mëtejshme edhe e besimit në Qeveri. Besimi në Qeveri është rritur në 51% nga 4,6% në vitin 2007 dhe 26,6% në vitin 2006. Është e mundur lidhshmëria e rritjes së besimit në Qveri me rritjen e besimit në shtet në 48,1%, mes 38,6% në vitin 2007 dhe 29,2% në vitin 2006.

Te sektori afarist, qytetarët si edhe në vitet paraprake shprehën besim më të madh në mikro ndërmarrjet (59,9%), përkundër ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (48,9%), gjegjësisht ndërmarrjet e mëdha (45,7%).

Krahasuar me vitin e kaluar, jotoleranca ndaj të gjitha grupeve përveç te njerëzit e varur nga alkooli dhe te viktimat nga dhuna është në rritje.

Sa i përket besimit në shoqërinë civile, qytetarët më së shumti u besojnë kishave dhe bashkësive fetare (65,6%), derisa ka ndarje në besimin ndaj organizatave qytetare (41,2%). Pakicë e vogël e qytetarëve kanë besim në sindikatat (20,1%) dhe në odat ekonomike (23,3%).

Hulumtimi tregoi se besimi i përgjithshëm në organizatat qytetare është 41,7%. Shumica e qytetarëve besojnë se organizatat qytetare janë për realizimin e interesave të qytetarëve dhe mundësi që mendimi dhe veprimi i tyre të arrijë deri te opinioni. Qëndrimet se organizatat qytetare janë mjet me të cilat individë të shkathët arrijnë deri te të hollat dhe ndikimi dhe/ose u shërbejnë interesave të shteteve të huaja dhe të fondacioneve të tyre janë pakicë. Për 81,8% të qytetarëve, organizatat qytetare janë keqpërdorur nga partitë politike dhe prapa tyre fshihen parti politike, por pakicë e vogël (25%) këtë mund ta ilustrojnë me shembull të ndonjë organizate qytetare prapa së cilës fshihet parti politike. Kjo mund të fletë për stereotip të lidhshmërisë mes partive politike dhe organizatave qytetare, që nuk është mbështetur me argumente konkrete.

Njohja e përgjithshme e organizatave qytetare është e mirë. Shumica e qytetarëve (56,1%) njohin organizata të suksesshme qytetare, ndërsa krahasuar me më parë njohin dhe dinë më shumë organizata të cilat punojnë në fusha konkrete. Njohja e organizatave qytetare është përmirësuar në të gjitha fushat e studiuara në krahasim me vitin 2007. Më së shumti janë të njohura organizata të cilat punojnë në zvogëlimin e varfërisë, ndërsa më pak ato që punojnë në zhvillimin ekonomik. Opinioni ka mendim pozitiv për organizatat qytetare.

## INDEKSE

Besimi i përgjithshëm		
Familja	97,8	↔
Besimi në institucionet		
Shteti	48,1	↑↑
Sektori afarist (privat biznes)	47,0	↓
Sektori qytetar (joqeveritar)	41,7	↓
Parti politike	29,8	↑↑
Mediumet	53,6	↔
Bashkësia ndërkombëtare	42,8	↓
Indeksi i besimit në institucionet	43,9	↔
Besimi në sektorin shtetëror		
Kryetari i Republikës së Maqedonisë	35,6	↔
Qeveria e Republikës së Maqedonisë	51,0	↑↑
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë	38,0	↑↑
Gjyqësia e Republikës së Maqedonisë	21,2	↔
Institucionet arsimore	65,8	↔
Ndërmarrjet publike komunale	38,8	↓↓
Organizatata publike shëndetësore	55,1	↑↑
Pushteti lokal	44,7	↔
Armata e Republikës së Maqedonisë	64,6	↔
Policia e Republikës së Maqedonisë	56,6	↔
Besimi në sektorin afarist		
Ndërmarrjet e mëdha	45,7	↔
Të vogla dhe të mesme	48,9	↓
Mikro (familjare)	59,9	↓↓
Besimi në sektorin civil		
Organizatata qytetare	41,2	↓
Kishat dhe bashkësitë fetare	65,6	↔
Sindikatat	20,1	↔
Odat ekonomike	23,3	↔

## Legjenda

↔	pa ose ndryshime të parëndësishme	Pa ose ndryshime të parëndësishme = 0 – 3 % Të vogla = 3,01 – 5 % Të matura = 5,01 – 10 % Të mëdha = mbi 10 %
↑	rritje e vogël	
↓	rënie e vogël	
↑↑	rritje e matur	
↓↓	rënie e matur	
↑↑↑	rritje e madhe	
↓↓↓	rënie e madhe	

<b>10 organizatat më të suksesshme qytetare</b>		
(Kryqi i Kuq i RM*), Most, FISHHM, El Hilal, LOGM, Megjashi, Transparenca Maqedoni, MCMS, KHDNJ, LSHPM		
<b>Indeksi i njohjes së organizatave qytetare në përgjigjet e prioriteteve shoqërore</b>		
Njohja e organizatave qytetare që çunojnë në fushën e varfërisë	52,2	↑↑↑
Pesë organizatat e para: (Kryqi i Kuq i RM)*, El Hilal, FISHHM, Kalliri i mirësisë, Megjashi, MCMS		
Njohja e organizatave që punojnë në fushën e luftës kundër korrupsionit	22,3	↑↑
Pesë organizatat e para: Transparenca Maqedoni, KHDNJ, Most, Zero korrupsioni – Transparenca, MCMS, LSUQM		
Njohja e pesë organizatave që punojnë në fushën e zhvillimit të ekonomisë	11,4	↑↑
Pesë organizatat e para: FISHHM, (odat ekonomike*), FZHMM, BSE, QZHI, MCMS		
Njohja e organizatave që punojnë në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile	36,0	↑↑
Pesë organizatat e para: Most, KHDNJ, FISHHM, MCMS, Transparenca Maqedoni		
<b>Indeksi i njohjes dhe qëndrimet për njëzet e katër organizatat qytetare</b>		
Njohja e organizatave qytetare	62,3	↔
Njohuri për organizatat qytetare	29,2	↔
Besimi në organizatat qytetare	21,4	↔
Qëndrime pozitive/negative për organizatat qytetare	3,5	
10 organizatat qytetare të para që kanë dëgjuar për ato	82,2	↔
10 organizatat qytetare të para që i dinë	46,6	↔
10 organizatat qytetare të para sipas besimit	34,7	↔
10 organizatat qytetare të para sipas qëndrimeve pozitive/negative	5,5	
<b>Indeksi i njohjes së personaliteteve nga organizatat qytetare</b>		
Njohja e personaliteteve nga shoqëria civile	48,9	↑↑
Besimi në personalitete nga shoqëria civile	28,4	↑
Besimi/Jobesimi në personalitete nga shoqëria civile	1,5	
10 personalitetet e para sipas njohjes nga shoqëria civile	54,3	↔
10 personalitetet e para sipas besimit nga shoqëria civile	31,6	↔
10 personalitete e para sipas besimit/jobesimit nga shoqëria civile	1,7	
<b>Indekse të njohjes së organizatave qytetare në përgjigje të prioriteteve shoqërore</b>		
Njohja e organizatave qytetare që punojnë në fushën e varfërisë	52,2	↑↑↑

\*Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë dhe odat ekonomike nuk janë regjistruar sipas Ligjit për shoqata të qytetarëve dhe fondacione, por me ligje tjera relevante, por janë përfshirë në kuptimin e gjerë të shoqërisë civile

## HYRJE

Në këtë raport janë analizuar rezultatet nga anketa “Besimi në shoqërinë civile në Republikën e Maqedonisë”, që u realizua në ekzemplarin kombëtar reprezentues të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë.

Qëllimi i studimit ishte të hulumtohet besimi i qytetarëve në organizatat qytetare dhe aktorët në organizatat qytetare.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) ia besoi anketën për mendimin publik, mbi të cilën u bazua ky raport, Institutit për Hulumtime Sociologjike dhe Juridiko-Politike (IHSJP), përgjegjësia e të cilit ishte edhe metodologjia e anketës.

Ky hulumtim u zbatua për herë të tretë. Hulumtimi i parë u realizua në prill të vitit 2006 dhe u botua në publikimin “Besimi, përgjegjësia për çështjet shoqërore dhe bamirësa në Maqedoni”, ndërsa në korrik të vitit 2007 u botua në publikimin “Besimi në shoqërinë civile”.

### Nocione dhe definicione

Në opinionin maqedonas dhe në rrethet profesionale nuk ekziston kuptim i ndërsjellë i konceptit (definicionit) të shoqërisë civile. Në këtë raport është përdorur definicioni nga Civikus – Indeksi i shoqërisë civile në Maqedoni (MCMS, 206). Ky definicion thotë “të gjitha shoqërimet formale dhe joformale, organizatat dhe rrjetet të cilat e plotësojnë hapësirën shoqërore mes familjes, sektorit afarist, partive politike dhe pushtetit, dhe të cilat shoqërohen për shkak të realizimit të qëllimeve de intereseve të përbashkëta”.

Sipas këtij definicioni në shoqërinë civile janë përfshirë organizatat qytetare (shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet), kishat dhe organizatat fetare, sindikatat, odat ekonomike dhe organizatat e punëdhënësve.

### Metodologjia dhe qasja

Hulumtimi është realizuar me anketë gojore në amvisëritë në tetor të vitit 2008 në ekzemplarin reprezentues prej 1.600 të anketuarve nga ana e Institutit për Hulumtime Sociologjike dhe Juridiko-Politike (IHSJP).

#### Pyetsori

Pyetsori për anketën janë ato që u përdorën në vitin 2006 dhe 2007, të ndryshuara në bazë të përvojës nga dy anketat paraprake. Pyetjet janë përgatitur nga autorët dhe nga ekipi i projekteve në MCMS, në bashkëpunim me ekspertë nga IHSJP.

Për arritjen e qëllimeve nga hulumtimi, me pyetësin u përfshinë variabilet që vijnë:

- Besimi i qytetarëve në institucionet nga sektori publik (shtetëror), afarist (privat) dhe civil;
- Qëndrime për shoqërinë civile;
- Informimi për organizatat qytetare dhe aktivitetet e tyre;
- Toleranca;
- Karakteristikat socio-demografike.

#### Ekzemplari

Anketa u realizua në tetor të vitit 2008 në ekzemplarin reprezentues prej 1.600 të anketuarve. Korniza e popullatës së ekzemplarit ishte popullata më e vjetër se 18 vjet, ndërsa kriteret për reprezentim ishin: gjinia, përkatësia etnike, mosha, vendi i banimit dhe rajonet.

Nga 1.600 të anketuar, 49,5% ishin gra, ndërsa 50,5% meshkuj, lidhur me përfaqësimin etnik, maqedonasit ishin përfaqësuar me 64,1%, ndërsa shqiptarët me 24,4%, ndërsa grupet tjera etnike ishin përfaqësuar me 11,5%. Lidhur me vendin e banimit, popullata fshatare ishte përfaqësuar me 29,6% derisa ajo e qytetit me 60,5% (Qyteti i Shkupit, me 21,9%).

#### Përpunimi dhe prezantimi i rezultateve

Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar me shpeshti dhe proporcion të përgjigjeve. Të dhënat janë me besueshmëri të saktësisë prej 95% dhe me gabim prej +/-5%. Rezultatet janë paraqitur në grafikone në nivel të gjithë ekzemplarit. Të dhënat përveç me grafikone janë shprehur edhe me numra. Përveç numrave është paraqitur edhe trendi në krahasim me vitin paraprak, për ato të dhëna të cilat mund të krahasohen me hulumtimin nga viti 2007. Legjenda e simboleve është si vijon:

↔	pa ndryshime ose të parëndësishme	Pa ose ndryshime të parëndësishme = 0 – 3 % Të vogla = 3,01 – 5 % Të matura = 5,01 –10 % Të mëdha = над 10 %
↑	rritje e vogël	
↓	rënie e vogël	
↑↑	rritje e matur	
↓↓	rënie e matur	
↑↑↑	rritje e madhe	
↓↓↓	rënie e madhe	

Për përmirësimin e vlerës së përdorimit të raportit dhe mundësinë për analizë dhe krahasim janë përdorur edhe indekset (treguesit). Në tabelën më poshtë janë dhënë sqarimet për indekset për organizatat qytetare.

Pakicë e parëndësishme përdoret për përgjigje më pak se 10% nga ekzemplari, pakicë e vogël për 11% deri më 30%, pakicë për 30% deri më 50%, shumicë për 51% deri më 70% dhe shumicë e madhe për më shumë se 70%.

### Grupi punues

MCMS inkuadroi disa bashkëpunëtorë të vet në të gjitha fazat e hulumtimit: Sasho Klekovski, drejtor i parë ekzekutiv, Aleksandar Krzhallovski, drejtor ekzekutiv, Sunçica Caydovska, udhëheqëse e Departamentit për shoqëri civile, Gonca Jakovleska, bashkëpunëtoreshë për marrëdhënie me opinionin dhe Daniella Stojanova, bashkëpunëtoreshë në projekte. Në ekipin e IHSPJ u inkuadruan Natsha Gaber-Damjanovska, Emilija Simovska, Aneta Jovevska, Klime Babunski dhe Petar Atanasov.

Indeksi i njohjes së organizatave qytetare në përgjigje të prioriteteve shoqërore	
Indeksi i njohjes së organizatave qytetare të cilat punojnë në fushën e varfërisë, luftën kundër korrupsionit, zhvillimin e ekonomisë dhe të cilat punojnë në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile	= $\Sigma$ e di
Indeksi i njohjes dhe qëndrime për njëzet e katër organizata qytetare	
Njohja e organizatave qytetare	= $\Sigma$ kam dëgjuar/numri i organizatave
Dinë organizata qytetare	= $\Sigma$ e d/numri i organizatave
Besimi në organizatat qytetare	= $\Sigma$ mendim pozitiv/numri i organizatave
Qëndrime pozitive/negative për organizatat qytetare	= $\Sigma$ sasia e qëndrimeve pozitive dhe negative/numri i organizatave
10 organizatat e para qytetare sipas të njohurit	= $\Sigma$ kam dëgjuar/10 organizatat e para
10 organizata e para qytetare që i dinë	= $\Sigma$ e di/10 organizatat e para
10 organizata e para qytetare për të cilat kanë besim	= $\Sigma$ mendim pozitiv/10 organizatat e para
10 organizata të para qytetare me qëndrime pozitive/negative	= $\Sigma$ sasia e qëndrimeve pozitive dhe negative/10 organizatat e para
Indeksi i njohjes së personaliteteve nga organizatat qytetare	
Njohja e personaliteteve nga shoqëria civile	= $\Sigma$ e di/numri i personaliteteve
Besimi në personalitete nga shoqëria civile	= $\Sigma$ besimi/numri i personaliteteve
Besimi/mosbesimi në personalitete nga shoqëria civile	= $\Sigma$ sasia e besimit dhe mosbesimit/numri i personaliteteve
10 personalitetet e para që i njohin nga shoqëria civile	= $\Sigma$ e di/10 personalitetet e para
10 personalitetet e para sipas besimit nga shoqëria civile	= $\Sigma$ besimi/10 personalitetet e para
10 personalitetet e para sipas besimit/mosbesimit nga shoqëria civile	= $\Sigma$ sasia e besimit dhe mosbesimit/10 personalitetet e para

## I. BESIMI DHE BESIMI NË INSTITUCIONET

### Hyrje

Besimi është komponentë kyçe e kapitalit social. Në përgjithësi, mund të identifikohen tre tipe të besimit: besimi në të ngjashmit, besimi i përgjithshëm dhe besimi në institucionet.

I pari është besimi social në të ngjashmit, besim i partikulizuar ose besim i personalizuar. Ky besim gjendet brenda në raportet e bazuara ose rjetet sociale (familja, miqtë, fqinjët etj.).


I dyti, besimi i përgjithshëm ose besimi social, e përfshin besimin në të panjohurit.

Besimi i tretë është besimi institucional, i cili referon në besimin e bazuar në institucionet formale të sundimit dhe të shoqërisë.


### Besimi në të ngjashmit dhe besimi i përgjithshëm

Qytetarët në Maqedoni në shumicë të madhe kanë besim në familje (97,8%), përkundër shumicës së madhe të qytetarëve (76,9%) të cilët mendojnë se duhet të jesh shumë i kujdesshëm me njerëzit. Besimi të përgjithshëm te njerëzit kanë 23,1%.

Grafikoni I.1. Beismi në njerëzit




Grafikoni I.2. Beismi në familje



### Besimi në institucionet

Me besimin në institucionet është hulumtuar besimi sipas qasjes tri sektoriale: shteti, sektori afarist (privat) dhe sektori civil. Mediat dhe partitë politike për shkak të mundësisë se mund t'i takojnë më shumë sektorëve janë ndarë veçmas. Tek ato është shtuar bashkësia ndërkombëtare.

Grafikoni I.3. Sa besim keni në:



Besimin e shumicës e kanë mediat. Afër shumicës janë shteti dhe sektori afarist. Besimi në shtet, i cili është në trend të rritjes, e tejkaloi besimin në bashkësinë ndërkombëtare dhe sektorin civil, i cili është në rënie në vogël në krahasim me vitin paraprak 207. Edhe më tej më pak besim qytetarët kanë në partitë politike, ku 37,4% prej tyre nuk kanë kurrfarë besimi.

Besimi në shtet është në trend të rritjes prej 29,2% në vitin 2006, 38,6% në vitin 2007 deri më 48,1% në vitin 2008. Besimi në shtet rritet edhe te maqedonasit etnik (në 51,8% prej 26,5% në vitin 2006) edhe te shqiptarët etnik (në 42,1% prej 36,2% në vitin 2006).

Në besimin ndaj sektorit afarist, partive politike dhe bashkësisë ndërkombëtare ka dallime në varësi prej përkatësisë etnike. Dallimet etnike në besimin ndaj sektorit civil u zvogëluan.

**Tabela I.1. Dallimet etnike në besimin ndaj sektorit afarist, partive politike dhe bashkësisë ndërkombëtare**

	Maqedonas etnik	Shqiptarë etnik
<b>Sektori afarist</b>	43,8	56,7
<b>Partitë politike</b>	26,2	42,3
<b>Bashkësia ndërkombëtare</b>	32,9	68,2

Ndaj bashkësisë ndërkombëtare kanë perceptcione të ngjashme edhe qytetarët të cilët e ndjejnë LSDM dhe VMRO-DPMNE si parti të vetën me besimin prej 38,6%, gjegjësisht 37,3%.


Të rinjtë (prej 18 deri 25 vjet) kanë besim të madh në sektorin afarist (54,8%), në sektorin civil (45,6%) dhe në bashkësinë ndërkombëtare (51,9%).

Bujqit kanë besim të madh në sektorin civil (50%). Perceptcione të ngjashme ndaj sektorit civil kanë qytetarët të cilët e ndjejnë LSDM dhe VMRO-DPMNE si parti të vetën me besim prej 45,1%, gjegjësisht 40,9%.

## Besimi në sektorin shtetëror

Institucione të ndryshme kontribuojnë ndryshëm drejt besimit në shtet.

**Grafikoni I.4. Besimi në sektorin shtetëror**



Për herë të parë nga viti 2006 Qeveria ka besim te shumica (51%).

Institucionet arsimore, armata, policia dhe organizatat publike shëndetësore, e kanë besimin e shumicës, ndërsa vetëqeverisja lokale dhe ndërmarrjet komunale publike të pakicës. Kryetari dhe Kuvendi i Maqedonisë e kanë mbështetjen e pakicës. Qytetarët kanë më pak besim te gjyqësia.

Në rritje është besimi ndaj Qeverisë, Kuvendit dhe organizatave publike shëndetësore. Ka rënë besimi në ndërmarrjet komunale publike, ndërsa institucionet tjera janë pa ndryshime.

Qeveria ka rritje të besimit për 6,4%, gjegjësisht besimi është rritur në 51% prej 44,6% në vitin 2007 dhe prej 26,6% në vitin 2006. Besimi në Qeveri është rritur te maqedonasit etnike (në 56,2% prej 46,3%), ndërsa gjendet në nivel të njëjtë si më parë te shqiptarët etnike (38,5%). Besim më të vogël ka te të rinjtë prej 18 deri 25 vjet (37,4%). Qeveria ka besim prej 35,9% te qytetarët të cilët e ndjejnë si parti të vetën LSDM, ndërsa 74,9% te qytetarët të cilët e ndjejnë si parti të vetën VMRO-DPMNE.

Besimi në Kryetarin e Republikës është 35,6% (35,1% në vitin 2007). Besim te Kryetari kanë 40,4% të maqedonasve etnik dhe 18,7% te shqiptarët etnik. Kryetari ka besim te 24,3% të qytetarëve të cilët VMRO-DPMNE e ndjejnë si partë të vetën, ndërsa 72,8% te qytetarët të cilët e ndjejnë LSDM si parti të vetën.

Armata dhe policia kanë besim te shumica e qytetarëve. Besimi në polici është rritur te maqedonasit etnik në 62,6% prej 52,1% në vitin 2007, ndërsa te shqiptarët etnik është 42% dhe është në nivel të njëjtë si në vitin 2007 (45,6%).


Vetëqeverisja lokale e mban besimin e deritanishëm. Si edhe në vitet e kaluara besim akoma më të madh kanë shqiptarët etnik (55,6%), që te maqedonasit etnik është 41,7%. Vetëqeverisja lokale ka besim më të madh në rajonet e Pollogut (64,6%), të Pellagonisë (57,4%) dhe Juglindor (49,3%), në mesatare janë rajoni Jugperëndimor, i Vardarit dhe i Shkupit, ndërsa besim më të vogël ka në rajonin Verilindor (32,3%) dhe Lindor (24,4%).

Në ndërmarrjet komunale publike kanë besim 38,8%. Besim më të lartë ka në rajonin Juglindor (51,4%) dhe atë të Pellagonisë (43,7%). Në rajonin e Pollogut ka besim të lartë në vetëqeverisjen lokale (64,6%) dhe besim më të ulët në ndërmarrjet komunale publike (34,3%).

## Besimi në sektorin afarist

Në besimin në sektorin afarist është hulumtuar besimi në ndërmarrjet mikro (familjare), të mesme dhe të vogla, si dhe në ndërmarrjet e mëdha. Në përgjithësi ka trend (neznacitelen) të zvogëlimit të besimit në të gjitha ndërmarrjet.

Grafikoni I.5. Besimi në sektorin afarist




Qytetarët si edhe në vitet e kaluara shprehën besim më të madh në mikro ndërmarrjet përkundër ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, gjegjësisht ndërmarrjet e mëdha. Siç rritet madhësia e ndërmarrjes ashtu zvogëlohet besimi në atë, pa dallim të moshës, arsimimit, gjinisë etj. Kjo është në korrelacion me besimin e lartë në familje (besimi në të ngjashmit).

Lidhur me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), ekziston tendencë për rritjen e besimit në ato nga ana e të anketuarve me nivel të arsimimit të lartë.

## Besimi në sektorin civil

Qytetarët kanë besim më të madh në kishat dhe bashkësitë fetare (65,6%), deri sa ka ndarje në besimin ndaj organizatave qytetare. Pakicë e vogël e qytetarëve kanë besim në sindikatat dhe në odat ekonomike.

Grafikoni I.6. Sa besim keni në:




Besimi në organizatat qytetare është zvogëluar në 41,2% nga 45,4% në vitin 2007 dhe 50,3% në vitin 2006. Besim më të lartë prej 49,5% kanë të rinjtë prej 18 deri 25 vjet (49,5%), nxënësit dhe studentët (56,8%) dhe bujqit (58%). Besim të ngjashëm kanë edhe maqednasti etnik (40,6%) dhe shqiptarët etnik (43,1%). Besim më të ulët kanë qytetarët me të ardhura më të ulta – nën 2000 denarë/anëtar (33,8%), me arsim fillor (32,7%) dhe në Shkup (36%). Në organizatat qytetare kanë besim të ngjashëm edhe qytetarët që LSDM dhe VMRO-DPMNE e ndjejnë si parti të vetën, me 44,6%, gjegjësisht 40,7%. Besim më të ulët prej 18,8% kanë qytetarët që e ndjejnë VMRO-PP si partinë e tyre.

## Besimi në profesionet

Shumica e qytetarëve kanë besim në arsimtarët/profesorët, mjekët, personat fetar dhe policët. Besim më të ulët, këtë vit, kanë gjykatësit (20,7%). Besimi në arsimtarët, profesorët dhe mjekët lidhur me vitin e kaluar është rritur për 6,4% gjegjësisht 12,3%. Edhe pse në fund të listës së besimit, këtë vit janë edhe doganierët, kanë rritje të besimit prej 9,6% ndërsa ulje të besimit te gjykatësit për 4,8%.

Grafikoni I.6. Besimi në profesionet



Besimi në profesionet (arsimtarët/profesorët, policët, konsulentët afarist, gjykatësit) kryesisht e ndjek besimin në institucionet. Si dhe vitin e kaluar, te dy profesione ka dallime> besimi te mjekët (66,8%) është më e madhe nga besimi në organizatat publike shëndetësore (55,1%), ndërsa besimi në personat fetar (54%) është më e vogël se besimi në kishat dhe bashkësitë fetare (65,6%).

Besim më të madh te arsimtarët/profesorët kanë ata nga rajoni i Shkupit (74,8%) si dhe te anketuarit që kanë të ardhura më të larta se 12.000 denarë (79,6%). Gjykatësve më së paku u besojnë të papunësuarit (81,9%). Policësve më së shumti u besojnë të anketaruto nga rajoni i Pelagonisë (82,3%), ndërsa më pak të anketuarit nga rajoni i Pollogut (64,2%). Në rajonin e Pelagonisë më së shumti u besojnë doganierëve (51,1%). Besimi te personat fetar zvogëlohet me rritjen e shkallës së arsimit nga 70,6% te personat me arsim fillor të papërfunduar në 46,5% te ata me arsim të lartë dhe sipëror. Arsimi ndikon edhe te besimi në konsulentët afarist, kjo rritet prej 26,5% te ata me arsim fillor të papërfunduar në 44% te ata me arsim të lartë dhe sipëror.

## Përfundime

### **Relativisht besim i ulët i përgjithshëm dhe besim në institucionet**

Qytetarët kanë besim të lartë në t ngjashmit – besim në familje (97,8%) dhe besim më të ulët të përgjithshëm (23,1%) dhe besim në institucionet (indeksi 43,9%).

Indeksi i besimit në institucionet është 43,9%, me rritje të besimit në shtet (48,1%) dhe zvogëlimin e besimit në sektorin afarist (47%), sektorin civil (41,7%) dhe në bashkësinë ndërkombëtare (42,8%). Mediat (53,6%) dhe vetëqeverisja lokale (44,7%) kanë besim stabil.

Institucionet arsimore (65,8%), armata (64,6%), policia (56,6%) dhe organizatat publike shëndetësore (55,1%) e kanë besimin e shumicës, ndërsa ndërmarrjet komunale publike (38,8%) të pakicës. Kryetari (35,6%) dhe Kuvendi i Maqedonisë (38%) e kanë mbështetjen e shumicës. Qytetarët më së paku kanë besim në gjyqësinë (21,2%).

### **Rritje e mëtejshme e besimit në Qeveri (dhe në shtet)**

Besimi në Qeveri është më e lartë për 6,4% në krahasim me besimin e rritur në 51% nga 44,6% në vitin 2007 dhe 26,6% në vitin 2006. Besimi në Qeveri është rritur te maqedonasit etnik (në 56,2% nga 46,3%), ndërsa është në nivel të njëjtë si më parë t shqiptarët etnik (38,5%). Qeveria ka besim te 35,9% të qytetarëve që e ndjejnë LSDM si partinë të tyre.

Lidhje e mundshme e rritjes së besimit në Qeveri është rritja e besimit në shtet në 48,1%, mes 38,6% në vitin 2007 dhe nga 29,2% në vitin 2006.

### **Rritja e besimit në organizatat shëndetësore publike dhe te mjekët**

Besimi në organizatat shëndetësore publike është më e lartë për 6% dhe është rritur në 55,1% nga 49,1% në vitin 2007. Mjekët kanë edhe rritje më të lartë t besimit për 11,6% dhe kjo është rritur në 66,1% nga 54,5% në vitin 2007.

### **Te organizatat qytetare njëloj kanë besim edhe bashkësitë etnike edhe partitë politike, a më së shumti besim kanë të rinjtë**

Në organizatat qytetare besim të ngjashëm kanë edhe maqedonasit etnik (40,6%) edhe shqiptarët etnik (43,1%) edhe qytetarët të e ndjejnë LSDM dhe VMRO-DPMNE si parti të tyre, me 44,6%, gjegjësisht 40,7%. Besim më të madh prej 49,5% kanë të rinjtë prej 18 deri 25 vjet (49,5%), nxënësit dhe studentët (56,8%) dhe bujqit (58%).

### **Rritje e besimit në profesionet (profesorë, mjek, doganierë) me përjashtim të gjykatësve**


Besimi në profesionet është në rritje, veçanërisht te profesorët (71,1%), mjekët (66,8%) dhe doganierët (27,3%). Besimi në profesorët dhe mjekët e tejkalon besimin në institucionet ku punojnë. Përjashtim është besimi te gjykatësit (20,7%) që është në rënie të vogël.

## II. TOLERANCA

Shumicë e madhe e të anketuarve nuk dëshirojnë të kenë fqinjë të varur nga droga, alkooli, persona të sëmurë nga aids dhe homoseksualë. Shumica nuk i duajnë për fqinj viktimat e dhunës dhe romët, deri sa pakica nuk dëshuron të jetojë bashkë me emigrantët/punëtorë të huaj. Pakicë e vogël e të anketuarve nuk dëshirojnë për fqinjë t'i kenë njerëzit nga feja tjetër, përkatësia etnike dhe çifte jo të kurorëzuara që jetojnë bashkë.

Dallimi mes përkatësisë tjetër etnike dhe romëve është në nivel të njëjtë si dhe vitin e kaluar, që flet se stigmatizimi më i madh të romët akoma është prezente.

**Grafikoni II.1. A keni dëshirë grupet që vijojnë t'i keni për fqinjë?**



Krahasuar me vitin e kaluar, jotoleranca ndaj të gjitha grupeve përveç ndaj njerëzve të varur nga alkooli dhe të viktimat e dhunës është në rritje. Numri i atyre që nuk dëshirojnë fqinj nga përkatësia tjetër etnike është rritur për 4,3% (nga 25,9% në 30,2%), te ata që nuk dëshirojnë fqinj nga feja tjetër për 3,4% (nga 27,2% në 30,6%), ndërsa rritje më të madhe ka te ata që nuk dëshirojnë fqinj emigrantë/punëtorët të huaj – 18,8% (nga 17,7% në vitin 2007 në 36,5% në vitin 2008).

Për të gjitha grupet, përveç për personat të varur nga droga ekzistojnë dallime socio-demografike. Shqiptarët etnik janë më tolerantë se maqedonasit etnik ndaj të sëmurëve nga aids, ndaj homoseksualëve, ndaj viktimave të dhunës dhe ndaj çifteve jo të kurorëzuara që jetojnë bashkë.

**Tabela III.1. Dallimet etnike në tolerancë ndaj grupeve të caktuara të njerëzve**

	Maqedonasit etnik	Shqiptarët etnik
<b>Persona të sëmurë nga aids</b>	18,7 %	7,4 %
<b>Homoseksualë</b>	20,6 %	8,2 %
<b>Viktima të dhunës</b>	45,5 %	32,6 %
<b>Çifte jo të kurorëzuara që jetojnë bashkë</b>	79,8 %	49,7 %

Shkalla e arsimimit ndikon te toleranca ndaj të gjitha grupeve, përveç te personat e varur nga alkooli dhe droga. Arsimit më i lartë – shkallë më e lartë e tolerancës është rregull te të gjitha grupet përveç të romët dhe emigrantët/punëtorët e huaj ku ky raport është anasjelltas, gjegjësisht niveli më i lartë i arsimimit – toleranca më e ulët.

Të ardhurat mujore ndikojnë në qëndrimet për tolerancën ndaj personave të sëmurë nga adis, ndaj viktimave të dhunës dhe ndaj çfiteve jo të kurorëzuara që jetojnë bashkë , deri sa në raste të personave të varur nga alkooli më tolerantë janë ata me të ardhura më të ulta.

Duke i krahasuar nëpër regjione, banorët e rajonit të Pellagonisë janë më tolerantë ndaj personave na përkatësia tjetër etnike, ndaj personave me fe tjetër, ndaj emigrantëve/punëtorëve të huaj dhe ndaj viktimave të dhunës. Moshë ndikon në tolerancën ndaj homoseksualëve, më saktë më të rinjtë (30,2%) janë më tolerantë se sa të moshuarit (8,%). Anëtarët e organizatave qytetare shprehin tolerancë më të lartë ndaj personave të sëmurë nga aids (25,6% përkundër 14,4% të atyre që nuk janë anëtarë), ndaj homoseksualëve (27,1% përkundër 16% të atyre që nuk janë anëtarë).

## **Përfundim**

### **Rritja e jotolerancës ndaj grupeve të caktuara**

Në Maqedoni është në rritje jobesimi dhe jotoleranca ndaj grupeve të ndryshme. Në krahasim me vitin e kaluar për të gjitha grupet, përveç për personat e varur nga alkooli dhe për viktimat e dhunës, rezultatet tregojnë rritje të jotolerancës.


Në rritje është jotoleranca ndaj personave me përkatësi tjetër etnike për 4,3%, ndaj personave me fe tjetër për 3,4% dhe veçanërisht nga emigrantëve/punëtorëve të huaj për 19,8%.

### III. BESIMI NË KISHAT DHE BASHKËSITË FETARE

Në kuadër të hulumtimit të MCMS për besimin në shoqërinë civile, u hulumtua edhe besimi në kishat dhe bashkësitë fetare. Nga të gjithë anëtarët e shoqërisë civile (organizatat qytetare, sindikatat dhe odat ekonomike), qytetarët kanë besim më të madh në kishat dhe bashkësitë fetare (65,6%). I ngjashëm është edhe besimi në personat fetar.

Në nivel të institucioneve individuale, me besim më të madh është Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM) me 53,8%, pastaj Bashkësia Islame e Maqedonisë (BIM) me 38,5%. Bashkësitë tjera fetare janë me 21% të besimit.

Grafikoni III.1. Sa besim keni në:



Besimi në kishat dhe bashkësitë fetare ka lidhshmëri me përkatësinë etnike. Maqedonasit etnik, duke supozuar lidhje me krishterimin ortodoks, kanë besim të lartë prej 70% në KOM, dhe besim të ulët prej 22% në BIM. Shqiptarët etnik, duke supozuar lidhshmërinë me islamin, kanë besim të lartë prej 77% në BIM dhe besim të ulët prej 11% në KOM.

Te BIM, mbështetje e madhe vërehet te njerëzit me arsim fillor dhe më pak se ajo (60-65%). Në parametrat tjera, duke përfshirë edhe kishat tjera dhe bashkësitë fetare, nuk ka përjashtime lidhur me besimin.

## Përfundime

### **Kishat dhe bashkësitë fetare me besim të lartë dhe stabil**

Besimi i përgjithshëm në kishat dhe bashkësitë fetare është i lartë (65,6%) dhe stabil – në nivel të njëjtë si vitine kaluar. Personat fetar kanë besim prej 54%.

Besimi në kishat dhe bashkësitë fetare është më i madh te qytetarët me arsimim më të ulët.

### **Besim i madh te të vetët: maqedonasit etnik te KOM, shqiptarët etnik te BIM**

KOM ka besimin e shumicës (53%).

Të gjitha kishat dhe bashkësitë fetare kanë besim të lartë te ithtarët e supozuar (besimtarët, anëtarët).

Besimi është shprehur te të ngjashmit – në KOM kanë besim të lartë prej 70% të maqedonasve etnik, ndërsa në BIM besim të lartë 77% të shqiptarëve etnik.

### **Mosbesimi në të ndryshmit, jotolerancë e mundshme fetare?**

KOM ka besim prej 11% mes shqiptarëve etnike, ndërsa BIM ka besim prej 2% mes maqedonasve etnik.


Kishat dhe bashkësitë e vogla si ajo katolike, metodiste dhe hebraike kanë besim prej 21%. Edhe pse besimi shpesh herë e tejkalon numrin e anëtarëve të kishave dhe bashkësive të përmendura, megjithatë shumica e qytetarëve prej rreth 79% shprehin mosbesim ndaj kishave dhe bashkësive të vogla fetare.

Këto të dhëna mund të flasin për jotolerancë fetare. Kjo është mbështetur edhe me 30,6% të qytetarëve që nuk dëshirojnë të kenë fqinj me besim fetar tjetër.

## IV. QËNDRIME PËR ORGANIZATAT QYTETARE

Në këtë grup të pyetjesh, të anketuarit janë pyetur të zgjedhin dy nga katër qëndrimet e paraqitura, sipas prioritetit të tyre. Përgjigjet janë analizuar nëpërmjet përqindjeve të përgjithshme (të mbledhura shumat për prioritetin e parë dhe të dytë për çdo pyetje/qëndrim)

Grafikoni IV.1. Qëndrime për organizatat qytetare



Ka barazi të madhe mes qëndrimeve – për të katër qëndrimet janë deklaruar mes 47% dhe 53% të anketuarve. Për dallim nga viti i kaluar, tashmë nuk janë mendime të shumicës (gjithsej 48,0%) se shumica e organizatave qytetare janë mjet me të cilët individë të shkathtë vijnë deri te të hollat dhe ndikimi (25,4%) dhe se ato u shërbejnë shteteve të huaja, me ndihmën e të cilave organizohen dhe financohen.

Kësaj here shumica e mendimeve (gjithsej 51,9%) se organizatat qytetare shërbejnë për realizimin e interesave të qytetarëve (33,1%), gjegjësisht se shumë njerëz të aftë nuk janë të organizuar partiakisht dhe organizatat qytetare mundësojnë që mendimi i tyre të arrijë në opinion (18,1%). Kjo rritje (për 9%) te ata këto dy qëndrime, të cilat janë pozitive për organizatat qytetare, në llogari të qëndrimeve negative (rënie prej 4%).


Kjo pjesërisht është jokonzistente me rënien e besimit në organizatat qytetare në këtë vit, por mund të komentohet se edhe krahas rënies së besimit të përgjithshëm në organizatat qytetare, ka ndryshim pozitiv në mendimet për cilësinë e punës së tyre.

### Organizatat qytetare dhe partitë politike

Shumica e qytetarëve (52,7%) mendojnë se partitë politike i keqpërdorin organizatat qytetare, gjegjësisht i përfitojnë qëndrimet e tyre kur kanë interes politik, ndërsa kur nuk kanë interes – i dënojnë si të afërt me palën tjetër. Pothuaj 30% të anketuarve mendojnë se partitë themelojnë organizata qytetare dhe i përdorin si kumtues të tyre.

Pakicë e vogël (18,2%) të qytetarëve mendojnë se partitë mbajnë llogari për qëndrimet e organizatave qytetare, por edhe kjo është zhvendosje e madhe nga viti i kaluar, kur këtë mendim e kishin vetëm 7,7% të anketuarve.

## Grafikoni IV.2. Partitë politike dhe liderët e tyre:



Përkundër përgjigjeve lidhur me partitë politike dhe organizatat qytetare, në pyetjen e drejtpërdrejtë për përkatësinë ideologjike ose partiake të organizatave qytetare edhe më tej pakicë e parëndësishme e qytetarëve mendojnë se ka lidhshmëri të tillë.

Diçka më shumë qytetarë se vitin e kaluar, kanë mundur të përmendin organizatë konkrete për të cilën mendojnë se ka lidhje me ndonjë parti politike (rreth 25% përkundër 20% në vitin 2007), por edhe më tej përqindja për organizatat individuale është e parëndësishme (5,1% në raste maksimale, ndërsa nën 1,3% për të gjitha organizatat jashtë nga tre të parat në listë).

**Tabela III.1. Përmendni organizatë prapa së cilës qëndron parti e caktuar politike dhe/ose liderë të tyre dhe i shfrytëzojnë si kumtues të tyre:**

Organizate	%
<b>Most</b>	5,1
<b>FISHHM</b>	4,8
<b>Transparenca</b>	4,2
<b>LSUQM</b>	1,3
<b>MCMS</b>	1,2
<b>LOGM</b>	1,0
<b>KHDNJ</b>	1,0
<b>Zgjohu</b>	0,7
<b>ADI</b>	0,6
<b>Drita</b>	0,5
<b>Sindikati</b>	0,5
<b>Të tjera</b>	4,8
<b>Pa përgjigje</b>	74,4

## Përfundime

### **Për interesat e qytetarëve**

Shumica e qytetarëve të Maqedonisë besojnë se organizatat qytetare janë për realizimin e interesave të qytetarëve dhe mundësi që mendimi i tyre dhe veprimi të arrijë në opinion. Qëndrimet se organizatat qytetare janë mjet me të cilat individët shkathët vijnë deri te të hollat dhe ndikimi dhe/ose u shërbejnë vetëm interesave të shteteve të huaja dhe fondacioneve të tyre janë pakicë.

Në krahasim me vitin e kaluar, dallimi i dy qëndrimeve pozitive dhe negative tani është 3,9%, që është përmirësim i dukshëm nga vjet -9,6% dallim (ose ndryshim i përgjithshëm pozitiv prej 13,5%), edhe se në periudhën e njëjtë është zvogëluar besimi i përgjithshëm në organizatat qytetare.

### **Organizatat qytetare janë jopartiake, por të keqpërdorura nga partitë**

Të anketuarit kanë deklaruar se organizatat qytetare janë keqpërdorur (81,8%) nga partitë politike ose nga liderët e tyre, që është rritje e dukshme (rreth 10%) në krahasim me vitin e kaluar dhe është në pajtim me besimin e përgjithshëm të zvogëluar në organizatat qytetare.

Megjithatë, pakicë e vogël (rreth 25%) prej tyre kanë mundur të përmendin organizatë konkrete qytetare prapa së cilës mendojnë se qëndron parti politike (në të gjitha rastet individuale, kjo përqindje është e parëndësishme – më pak se 5,1%).

Kjo mund të flet për stereotip për lidhshmërinë e partive politike dhe organizatave qytetare, që nuk është mbështetur me argumente konkrete.

## V. NJOHJA DHE MENDIME PËR ORGANIZATAT QYTETARE NË MAQEDONI

### Hyrje


Hulumtimi i përfshiu njohjet dhe qëndrimet për organizata konkrete qytetare dhe personalitete nga sektori civil.

Krahas njohjes së përgjithshme të organizatave qytetare, u hulumtua edhe njohja e organizatave qytetare që punojnë në fusha konkrete.

### Njohja e organizatave qytetare

Të anketuarit janë pytur të përmendin organizata të suksesshme pa u përkujtuar ose pa iu dhënë shembuj.


Grafikoni V.1. Organizata të suksesshme qytetare




Shumica e qytetarëve (56,1%) dinë të përmendin organizatë të suksesshme qytetare, 43,3% nuk dinë, ndërsa vetëm 0,6% mendojnë se nuk ka të tilla.

Njohja e organizatave qytetare të cilat punojnë në luftën kundër varfërisë, zhvillimin e shoqërisë civile, luftën kundër korrupsionit dhe zhvillimin ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillimin ekonomik dhe punësimin është hulumtuar duke kërkuar nga të anketuarit të përmendin organizatë konkrete pa u përkujtuar ose pa iu dhënë shembuj.

Njohja e organizatave të cilat punojnë në këto fusha është e ndryshme, gjatë së cilës realitë është e mirë njohja e organizatave që punojnë në luftën kundër varfërisë, pastaj organizatat që punojnë në zhvillimin e shoqërisë civile, ato që punojnë në luftën kundër korrupsionit dhe më pak të njohura janë atë që punojnë në fushën e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillim ekonomik dhe punësim.


**Grafikoni V.2. Organizata të njohura qytetare që kontribuojnë në luftën kundër varfërisë**

Shumica e qytetarëve dinë të përmendin organizatë që punon në fushën e varfërisë. Në krahasim me vitet e kaluara paraqitet trend i zvogëlimit të numrit të qytetarëve që nuk dinë të përmendin asnjë organizatë qytetare që punonj në fushën e varfërisë prej 62,2% në 2006, në 48,5% në vitin 2007 dhe 45,4% në vitin 208. Gjithashtu lista është pasuruar me organizata të reja, gjegjësisht përmenden më shumë organizata në krahasim me vitet e mëparshme.

**Grafikoni V.3. Organizata qytetare të njohura të cilat kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë civile**


Mes organizatave që punojnë në zhvillimin e shoqërisë civile në krahasim me vitet e kaluara, të anketuarit përmendin numër të madh të organizatave. Edhe këtu ka trend të zvogëlimit të numrit të qytetarëve që nuk dinë të përmendin asnjë organizatë që punon në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile prej 70,9% në 2006, në 63,5% në 2007 dhe 59,7% në 2008.

**Grafikoni V.4. Organizata qytetare të njohura të cilat kontribuojnë në luftën kundër korrupsionit**



Pakicë e vogël e qytetarëve dinë të përmendin organizatë qytetare që punon në fushën e luftës kundër korrupsionit. Megjithatë ka rritje e atyre që i njohin në krahasim me vitin kaluar prej 12,7% në 22,3%.


**Grafikoni V.5. Organizata të njohura qytetare që kontribuojnë në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për zhvillim ekonomik dhe punësim**



Shumicë e madhe e qytetarëve nuk dinë të përmendin organizatë që kontribuon në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillimin ekonomik dhe punësimin. Megjithatë ka rritje të atyre që kanë përmendur organizatë të tillë në krahasim me vitin e kaluar prej 6,9% në 11,4%.

Të anketuarit janë pyetur për besimin në organizatat qytetare sipas sektorit.


Grafikoni V.6. Besimi në organizatat qytetare sipas nënsektorëve



Organizatrat për personat me kufizime dhe për fëmijë, të rinj dhe studentë janë me besim më të lartë te qytetarët.

Njohja e organizatave qytetare është hulumtuar edhe me përkujtimin e listët prej 24 organizatave. Është hulumtuar informimi i përgjithshëm (kanë dëgjuar) dhe njohja (dinë). Qytetarët shprehin informim të ndryshëm informimi dhe njohje të organizatave të ndryshme.

Grafikoni V.6. Kam dëgjuar/di për:



Duke kaluar nga informimi i përgjithshëm (kam dëgjuar) drejt njohësve (dinë) për çdo nga organizatat numri dukshëm bie, gjegjësisht për shumicën prej tyre numri përgjysmohet ose bie shumë. Personat me arsimim më të lartë, të rijtë, të punësuarit në sektorin publik, nxënësit dhe studentët dhe ata që jetojnë në qytete janë njohës më të mirë nga të tjerët për shumicën e organizatave. Te organizata të caktuara qytetare ka ndikim edhe përkatësia etnike, e ato njihen dukshëm më shumë nga një grup etnik në krahasim me tjerat.


Për organizata të caktuara ka ndryshime në krahasim me vitin e kaluar. Paraqitet rënie e madhe e informimit dhe rënie e matur r njohjes për FISHM (rënie prek 10,6%, gjegjësisht 6,3 poena të përqindjes), rënie e matur e informimit dhe njohjes për LEM, LOGM dhe LSHPM dhe rënie e matur e njohjes për Polio plus. Zvogëlimi i informimit dhe njohja janë më të mëdha në krahasim me hulumtimet e kaluara kur janë konstatuar ndryshime të vogla (kryesisht nën 5 poena të përqindjes). Rritje vërehet te Most ku ka rritje të madhe të njihkes dhe rritje e matur e informimit (12,3 gjegjësisht 9,6 poena të përqindjes), pasta te SHBHR Meseçina me rritje të madhe të informimit dhe njohje e matur (13,6 gjegjësisht 6,9 poena të përqindjes) dhe te BNJVL, Megjashi dhe Transparenca Maqedoni me rritje të matur të informimit.

### Qëndrime (pozitive/negative) për organizatat qytetare

Nga njohësit e secilës nga lista prej 24 organizatave është kërkuar të përgjigjen nëse kanë qëndrim pozitiv ose negativ për ndonjë organizatë adekuatë.

Qëndrimet pozitive për organizatat qytetare janë shpesh herë më të shpeshta në krahasim me ato negative. Dukuria e qëndrimeve negative për organizata konkrete kryesisht është te pakica e parëndësishme (deri 10%). Për 8 (1/3) nga 24 organizatat e dhëna qëndrimet negative janë mbo 10% (1,6 deri 20,4%) që paraqet pakicë të vogël të anketuarve.

**Grafikoni V.7. Raporti i qëndrimeve pozitive kundrejt atyre negative për organizata të caktuara qytetare**




Në opinion sundon mendimi pozitiv për të gjitha organizatat qytetare të hulumtuara. Raporti i qëndrimeve pozitive kundrejt atyre negative për të gjitha organizatat që janë përfshirë në hulumtimin, gjegjësisht në çdo të anketuar me qëndrim negativ vjen minimum 1,3 të anketuar me qëndrim pozitiv (për organizatat më ulët të ranguar) deri në maksimum 9,7 të anketuar me qëndrim pozitiv (për organizatën më lartë të ranguar). Në krahasim me vitin e kaluar ka ndryshime të vogla në krahasim me qëndrimet pozitive dhe negative të shumica e organizatave. Përjashtim me ndryshime më të mëdha janë: PDAS Megjashi me zvogëlim të raportit prej 23,8 në 9,7, Polio plus me zvogëlim prej 11,6 në 6,8 dhe El Hilal me rritje prej 4,4 në 7,8. Raporti i mesëm për grupin e organizatave në krahasim me vitin e kaluar shënon zvogëlim prej 4,4 në 3,5.

## Njohja e personaliteteve nga sektori civil


Истражувањето на познавањето на личности од граѓанскиот сектор е направено на принцип на препознавање од понudena lista од 13 личности заедно со nivni фотографии.

Grafikoni V.8. Njohja e personaliteteve nga sektori civil



Shumica e gjysmës së personaliteteve të ofruara (8, gjegjësisht 57%) janë njohur nga pakica e qytetarëve.

Grafikoni V.9. Raporti besimi kundrejt mosbesimit për personalitetet nga sektori civil



Raporti i besimit kundrejt mosbesimit është pozitiv për shumicën e personaliteteve të përfshira, që do të thotë numri i atyre që kanë besim në krahasim me ata që nuk kanë besim është më i madh. Megjithatë raporti besim/mosbesim për të gjitha personalitetet është shumi i ulët në krahasim me raportin mendime pozitive/negative të organizatave që ata i udhëheqin. Raporti i mesëm për personalitetet është në nivel të njëjtë si edhe vitin e kaluar dhe është 1,5.

## **Përfundime**

**Shumica e qytetarëve dinë për organizata të suksesshme qytetare, ndërsa në krahasime vitin e kaluar dinë edhe më shumë për organizatat që punojnë në fusha konkrete**

Shumica e qytetarëve (56,1%) kanë përmendur organizata qytetare për të cilat mendojnë se janë të suksesshme.

Njohja e organizatave qytetare është përmirësuar në të gjitha fushat e hulumtuara në krahasim me vitin 2007: lufta kundër korrupsionit për 9,6 poena të përqindjes, zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla hde të mesme për 4,5, shoqëria civile për 3,8 dhe lufta kundër varfërisë për 3,1 poena të përqindjes.

**Njohja e organizatave të cilat punojnë në luftën kundër varfërisë është më e mirë në krahasim me fushat tjera**

Vetëm për organizatat që punojnë në fushën e luftës kundër varfërisë shumica e qytetarëve (54,6%) dinë të përmendin organizatë konkrete. Në të gjitha fushat tjera ti hulumtuara (shoqëria civile, lufta kundër korrupsionit dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme) shumica e qytetarëve nuk janë të njoftuar me organizatë konkrete.

**Besimi rritet kur është e përgjithshme (organizata qytetare) drejt më konkretes (nënsektorët e organizatave qytetare)**

Besimi i përgjithshëm në organizatat qytetare është 41,7%, por kur nga të anketuarit është kërkuar të deklarohen për organizatat nga 10 nënsektorë konkret besimi është dukshëm lartë (gjegjësisht 55,17%).

**Arsimimi, mosha dhe statusi ekonomik kanë ndikim në njohjen e organizatave qytetare**

Personat me arsimim të lartë, të rinjtë, të punësuarit në sektorin publik dhe nxënësit dhe studentët kanë njohës të mirë të listës së ofruar të organizatave qytetare. Gjithashtu ata që jetojnë në qytete janë njohës më të mirë në krahasim me ata që jetojnë në fshat. Te disa organizata ndikim ka edhe përkatësia etnike.

**Opinionit ka mendim pozitiv për organizatat qytetare edhe pse kanë më pak besim te liderët e tyre**

Mendimi pozitiv për organizatat qytetare mbisundon te opinionit. Mendimi negativ paraqitet te një pakicë e vogël e qytetarëve.

Liderët e organizatave qytetare gjithashtu ata kanë koeficientë pozitiv të besimit, por ato janë më të ulët se koeficientët e mendimit pozitiv të organizatave adekuate.

**Raporti i mendimit pozitiv/negativ për organizatat qytetare është në rënie të vogël në krahasim me vitin e kaluar (prej 4,4 në 3,5)**

Mendimet negative për organizata konkrete qytetare shënojnë rritje relative në krahasim me ato pozitive.

## SHTOJCË: PYETSORI

BESIMI				
<b>P1. Marrë në përgjithësi, a mund t'ju besohet shumicës së njerëzve ose duhet të jemi të kujdesshëm me ata?</b>				
Mund t'ju besohet shumicës së njerëzve				
Duhet të jeni shumë i kujdesshëm				
<b>P2. A mund të na thoni sa besim keni në institucionet?</b>				
	Besim të madh	Besim i pjesërishtëm	Besim të vogël	Kurrfarë besimi
Familja				
Shteti				
Spektori afarist (biznes privat)				
Spektori qytetar (joqeveritar)				
Partitë politike				
Mediat				
Bashkësia ndërkombëtare				
<b>P3. A mund të na thoni sa besim keni në institucionet që vijojnë të shtetit?</b>				
Kryetari i Republikës së Maqedonisë				
Qeveria e Republikës së Maqedonisë				
Kuvendi i Republikës së Maqedonisë				
Gjyqësia				
Institucionet arsimore				
Ndërmarrjet komunale publike				
Organizatave shëndetësore publike				
Vetëqeverisja lokale (komunat)				
Armata e Republikës së Maqedonisë				
Policia e Republikës së Maqedonisë				
<b>P4. A mund të na thoni sa besim keni në institucionet që vijojnë të organizatave qytetare?</b>				
Organizata qytetare (OJQ, shoqata të qytetarëve, fondacione)				
Kishat dhe bashkësitë fetare				
Sindikata				
Odat ekonomike				
<b>P5. Tani do të numëroj disa kisha dhe bashkësi fetare. A mund të na thoni sa besim keni te ato?</b>				
Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM)				
Bashkësia Islame në Maqedoni (BIM)				
Bashkësia hebraike				
Kisha tjera të krishtera (katolike, protestante, metodiste)				
<b>P6. A mund të na thoni sa besim keni në format që vijojnë të sektorit afarist (privat)?</b>				
Ndërmarrje të mëdha				
Të vogla dhe të mesme				
Mikro (familjare)				
<b>P7. A mund të na thoni sa besim keni në profesionet që vijojnë?</b>				
Arsimtarë, profesorë				
Gjykatës				
Mjek				
Policë				
Doganierë				
Persona fetar				
Konsulentë afarist (biznes)				
TOLERANCA				
<b>P8. A dëshironi që grupet që vijojnë ti keni për fqinj?</b>				
	Nuk dua	Njëllor e kam		
Njerëz me përkatësi tjetër etnike				
Njerëz me fe tjetër				
Romë				
Emigrantë/punëtorë të huaj				
Të varur nga droga				
Të varur nga alkooli				
Persona të sëmurë nga AIDS				
Homoseksualë				
Viktima të dhunës (gra, fëmijë)				
Çifte jo të kurorëzuara që jetojnë bashkë				
QËNDRIME PËR SHOQËRINË CIVILE				
<b>P9. Ju lutem zgjedhni me prioritet nga 1 dhe 2 (ku 1 është prioriteti më i lartë) me të cilat dy qëndrime më së shumti jeni dakord.</b>				
Organizatave qytetare janë të organizuara nga ana e qytetarëve me qëllim të realizimit të interesave të qytetarëve.				
Organizatave qytetare u shërbejnë vetëm interesave të shteteve të huaja dhe fondacioneve me ndihmën e të cilave organizohen dhe financohen.				
Shumëp njerëz të aftë nuk janë të organizuar partiakisht. Organizatat qytetare mundësojnë që mendimi dhe veprimi i tyre të arrijë në opinion.				
Shumica e organizatave qytetare janë mjet me të cilin individë të shkathtë arrijnë deri te të hollat dhe ndikimi.				
<b>P10. Partitë politike dhe liderët e tyre:</b>				
Mbahjnë llogari për mendimet dhe qëndrimet e organizatave qytetare dhe i inkuadrojnë në vendim marrjet në nivel nacional dhe				

lokal				
Kur kanë interesa partiake i përfitojnë qëndrimet e organizatave qytetare, ndërsa kur nuk kanë interes i akuzojnë si të afërt me tjerët.				
Themelojnë organizata qytetare dhe i shfrytëzojnë si kumtues të tyre				
<b>P11. Përmendni një ose më shumë organizata qytetare prapa të cilave qëndron parti e caktuar politike dhe/ose lider të tyre dhe i shfrytëzojnë si kumtues të tyre?</b>				
<b>BESIMI NË SHOQËRINË CIVILE</b>				
<b>P12. Tani do të numëroj më shumë kategori/fusha të veprimit të organizatave qytetare. A mund të na thoni sa besim keni në organizatat qytetare të cilat veprojnë në këto fusha?</b>				
	Besim të madh	Besim i pjesërishtëm	Besim të vogël	Kurrfarë besimi
Demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i të drejtës				
Fëmijë, të rinjë dhe studentë				
Gratë dhe çështjet gjinore				
Mjedisi jetësor dhe natyra (ekologjia)				
Persona me kufizime				
Kultura				
Zhvillimi rural (bujqit, fermerët)				
Sport, hobi dhe rekrejim				
Kujdesi social (humanitare)				
Shoqata profesionale				
<b>P13. Përmendni një ose më shumë organizatë të suksesshme qytetare (aktive, rezultatet të aritura etj.) që i njihni:</b>				
<b>P14. Përmendni tre organizata në Maqedoni që sipas mendimit tuaj punojnë në luftën kundër varfërisë:</b>				
<b>P15. Përmendni tre organizata në Maqedoni që sipas mendimit tuaj punojnë në zhvillimin e shoqërisë civile</b>				
<b>P16. Përmendni tre organizata në Maqedoni që sipas mendimit tuaj punojnë në luftën kundër korrupsionit</b>				
<b>P17. Përmendni tre organizata në Maqedoni që sipas mendimit tuaj punojnë në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, zhvillim ekonomik dhe punësimi</b>				
<b>P18. Gjatë 123 muajve të kaluar, a mund të kujtoheni se ndonjëra organizatë i ka ndihmuar bashkësisë suaj në ndonjë mënyrë?</b>				
Po	Jo			
<b>P19. Cilat jani njohuritë tuaja dhe mendimet për organizatat që vijojnë:</b>				
1) Asnjëherë nuk kam dëgjuar për këtë organizatë		4) E njoh organizatën dhe kam mendim negativ		
2) Kam dëgjuar, por pothuaj nuk di asgjë		5) E njoh organizatën dhe kam mendim pozitiv		
3) E njoh organizatën ndhe kam mendim shumë negativ		6) E njoh organizatën ndhe kam mendim shumë pozitiv		
Asociacioni për Iniciativa Demokratike (AID)				
Komiteti i Helsinkut për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë				
Transparenca Maqedoni				
Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë				
Qendra për Iniciativa Qytetare				
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)				
Asociacioni Qytetar "Most"				
Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS)				
Fondacioni Instituti Shoqëria e Hapur Maqedoni (FISHHM)				
Qendra për Zhvillim Institucional (QZHI)				
Kryqi i Kuq i Maqedonisë				
El Hilal				
Shoqata Humanitare-Bamirëse e Romëve "Meseçina"				
Lidhja e Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë				
Lëvizja e Ekologjistëve të Maqedonisë (LEM)				
Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë "Megjashi"				
Lidhja e Studentëve të Universitetit "Qirili dhe Metodi" (LSUQM)				
Lidhja e Organizatave të Grave në Republikën e Maqedonisë (LOGM)				
Shoqata për Barazi, Solidaritet dhe Emancipim (BSE)				
Polio plus				
Bashkësia e Organizatave Invalidore e Maqedonisë				
Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje (FZHMMN)				
Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL)				
Habitat				
<b>P20. Sa besim keni në personalitet që vijojnë nga sektori civil?</b>				

	Ka besim të madh	Kreysisht ka besim	Kryesisht nuk ka besim	Nuk ka kurrfarë besimi	Nuk e njih
Vladimir Milçin					
Savka Todorovska					
Suad Misini					
Zvonko Shavreski					
Dragi Zmijanac					
Slagjana Taseva					
Mirjana Najçevska					
Sasho Klekovski					
Albert Musliu					
Todor Petrov					
Sasho Ordanovski					
Darko Aleksov					
Behixhudin Shehapi					